



## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

### PROCESVERBAL

#### Mbajtur më 15 gusht 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKS-së: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë;; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame znj.Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekspertit Veprues për Siguri në Bashkësi dhe z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Bekim Karagjia dhe z. Ryan Scherba – OSCE dhe z. Ollven Izmay përfaqësuesi i KFOR-it, z. Leutrim Krasniqi Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit; z. Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik; z.Alban Zeka, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit; z. Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, të respektuar anëtarë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të hapi mbledhjen e KKS-së.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

#### Rendi i Ditës

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi a ka dikush diçka rreth pikave të rendit të ditës.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi nëse i referohemi procesverbalit nga takimi i fundit ka qenë obligim i Drejtorit që i përfaqëson emergjencat këtu për të filluar me hartimin e Planit të Reagimit Emergjent, kishte 30 ditë afat për dorëzimin e draftit të parë dhe ne ende nuk kemi parë apo që na është dërguar si draft, kështu që kisha propozuar që si pikë e rendit të ditës të shtohet edhe hartimi i Planit të Reagimit Emergjent.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është në pushim vjetor, por ajo çfarë mund të them është se ato që u theksuan nga parafolësi janë punë të kryera dhe edhe hartimi i Planit të Reagimit Emergjent si dokument pritet së shpejti të procedohet në diskutim publik.

*Rendi i ditës u miratua njëzëri*

## **1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 08 qershor 2023**

*U miratua njëzëri*

## **2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** fillimisht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari.

**z. Nijazi Jashari,** theksoi, sa i përket raportit të punës së Policisë i referohem Raportit gjashtë mujor janar-qershor. Gjendja e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit policor është e qetë, e vlerësojmë të sigurt dhe e menaxhuar. Nuk kemi pas ndonjë rast i cili do të ndikonte në prishjen e gjendjes së sigurisë. Do i referohem në pika të shkurta raportit gjashtëmujor. Stacioni policor momentalisht i ka 115 zyrtarë policor, prej tyre 10 janë staf civil, 21 zyrtar policor kanë arritur tani nga gjenerata e fundit ku 3 prej tyre i kanë marrë menjëherë dhe këta 18 janë në fazën e trajnimit. Në detyra të ndryshme në Drejtorinë Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme, në kërkesë të tyre kanë kaluar 10 zyrtarë policor. Për shkak të problemeve shëndetësore të ndryshme 8 zyrtarë janë të ngarkuar me detyra të lehta, ku kemi edhe të liruar prej uniformës të cilët vijnë në Stacion lajmërohen por nuk kemi të drejtë ligjore ti angazhojmë me detyra. Gjatë këtij viti kemi pas 4 dorëheqje nga policia e Kosovës e që sipas informatave këta kanë shkuar jashtë vendit, e pritet te ketë edhe të tjerë, ndërsa 4 zyrtar janë pensionuar. Sipas statistikave gjatë këtij 6 mujori ka pas 1 vrasje, 4 tentim vrasje, 37 kanosje, 10 raste ngacmim, 2 raste ngacmim seksual, 21 raste sulmi, 32 raste lëndim i lehtë trupor, 1 rast lëndim i rëndë trupor, 1 rast i mos dhënies së ndihmës, 34 raste të dhunës në familje, 40 raste vjedhjeje, 38 raste vjedhje të rënda, 30 raste armë pa leje, 8 raste përdorim të armës, 202 arrestime, 69 persona të ndaluar në mbajtje, 539 asistime (Gjykatës, Komunës etj.) dhe 4468 tiketa të shqiptuara për kundërvajtje në trafik. Sa për njoftim është duke u implementuar struktura e re organizative në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe në nivel të Drejtorisë Rajonale, por edhe në Stacion Policor të Podujevës, ku ka ndryshime por stafi do të jetë i njëjtë. Stacioni Policor deri tash ka qenë kategoria A ndërsa me strukturë të re organizative është A1 edhe pse nuk janë ndryshime të mëdha. Në kategorinë e njëjtë me ne është e Fushë Kosova. Kjo ishte në pika të shkurtra sa i përket raportit. Probleme nuk ka aq të mëdha, angazhime kemi bukur shumë, me theks në pikën doganore në Merdare ku ka pritje të mëdha deri 4-5 orë nga bashkatdhetarët.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, të marrim informacionet edhe nga përfaqësuesi i KFOR-it, e pastaj hapim debatin, sepse siç shihet përfaqësuesja e FSK-së nuk qenka prezent.

**Përfaqësuesi i KFOR-it,** theksoi, sa i përket strukturës së KFOR-it në Komunë të Podujevës nuk ka ndonjë ndryshim. Ekipi ndërlidhës këtu në Komunë punon në

koordinim me institucionet publike dhe bashkëpunim me ekipet manovruese të KFOR-it sa i përket vijës kufitare. Tani për tani KFOR-i nuk ka parë ndonjë veprim i cili do të ndikonte në gjendjen e sigurisë në Komunë. Kah mesi i muajit shtator unë do të përfundoj detyrën këtu ku dhe do të bëhet dorëzim pranimi i detyrës. Unë në emër të ekipit tim ju falënderoj për bashkëpunimin.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, meqë përfaqësuesja e FSK-së mungon atëherë e përmbyllim çështjen e raportimit dhe e hap diskutimin.

**z.Shemsi Jashari**, theksoi, lidhur me raportin e Komandantit të Stacionit policor, jemi në dijeni se sezoni veror na sjell dyfishim si të njerëzve ashtu dhe të veturave sidomos në qytet, pa bërë përjashtim edhe në rrugët tjera, por tollovia e madhe është në qytet. Pyetja është Policia a ka pas plan të veçantë për menaxhimin e trafikut dhe tërë këtij fluksi që vijnë, e që ka qenë angazhim i përbashkët i Policisë dhe i institucioneve të cilat japin shërbime për qytetarë.

**z.Nijazi Jashari**, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit Komuna në masë të madhe ka ndihmuar dhe ka zbutur situatën në këtë aspekt, me leshuarjen në shfrytëzim të parkingut të Komunës për vetura të bashkatdhetarëve. Nënvizoi, ky nuk është viti i parë ku Policia përballlet me situatën e krijuar nga fluksi i madh i bashkatdhetarëve. Policia gjithherë ka pasur plan operativ dhe ka për menaxhimin e trafikut. Shtrohet pyetja se çfarë mund të bëhet, ne e kemi jo vetëm qytetin por edhe magjistralen ku kemi një kontroll të dyfishtë. Se a mund të bëjmë më shumë, mundemi jo vetëm ne por edhe strukturat dhe institucionet tjera relevant. Nënvizoi, veç sa për ilustrim rasti i gjuajtjes me armë, me pasoja të vrasjes dhe plagosjes që ndodhi në një lokal në Prishtinë, personi në fjalë 15 herë është ndaluar nga Policia për shkak të armë mbajtjes pa leje dhe sikur të merrte dënimin e merituar për këtë nuk do të ndodhte ajo. Jemi duke bërë plan të veçantë edhe ashtu kemi njësinë e biciklistëve, por z. Jashari ti je në dijeni sepse ke punuar edhe vet në polici dhe në çfarë do rasti qoftë si dhunë në familje apo tjetër ne jemi të detyruar të intervenojmë. E kanë bërë një ndryshim në orar në Polici, dhe dje na kanë dhënë një shkresë për të bërë një vlerësim të disa pyetësorëve e kjo nuk është duke na pëlqyer dhe nuk është duke funksionuar. Ne kemi operuar në 4 ndërrime dhe tani e kanë bërë për të operuar në 3 ndërrime sigurisht e kanë marrë përbazë rritjen e numrit të zyrtarëve policor dhe për këtë do ta bëjmë një vlerësim por orari nuk është i favorshëm për zyrtarët policor, sepse është i lodhshëm, 5 net rresht të punohet në ndërrimin e natës, kjo është e tepërt.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, jemi shumë të vetëdijshëm se në raportet e paraqitura para këtij këshilli keni theksuar se jeni me numër jo të mjaftueshëm të zyrtarëve policor, duke shtuar edhe shfrytëzimin e pushimeve, mosha e policëve, pastaj policët e rinjë që duhet përgatitur me trajnime shtesë e të gjitha këto. Kur flas për një plan nuk mendova vetëm për Policinë edhe pse është më e organizuara në kuptimin operativ, por edhe për institucionet lokale, Drejtoritë relevante. Pra nëse flasim për ndërgjegjësim, vetëdijësim të trafikut mendoj se Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit duhet ta ketë një plan për orientim të qarkullimit të veturave, për parkimin e tyre. Është mirë që komuna ka lëshuar parkingun për vetura të bashkatdhetarëve por sigurisht se nuk është i mjaftueshëm, dmth duhet menduar për alternativa shtesë. Në aspektin teknik të organizimit dhe pritjes mendoj se kemi shumë shembuj në rajon dhe mendoj është mirë të mësojmë prej tyre edhe pse nuk janë turistë për ne, janë familjarët tanë. Në aspektin e ngarkesës së trafikut dhe qarkullimit dhe shërbimet që ata i kërkojnë, mendoj se bashkë me bizneset, institucionet lokale, Policinë dhe subjektet tjera relevante duhet menduar se si mund të bëjmë që të organizojmë pritje që të kalohe më mirë e më lehtë kjo periudhë, që të zvogëlohet vonesa më pak në shërbime dhe për të ndikuar në zvogëlimin e rasteve

të aksidenteve. Pra kjo periudhë kohore kërkon një angazhim shtesë dhe një qasje proaktive, kështu që kisha rekomanduar që për vitin tjetër me menduar qysh tash se çfarë mund të bëjmë, në mënyrë që edhe neve të na lehtësohet jeta këta dy muaj, për të pasur mundësi qarkullimi lirshëm apo për kryerje të shërbimeve tjera më lehtë.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, se nuk mund të bëhen masa për riorganizim të trafikut për periudhën kohore korrik–gusht. Trafiku edhe ashtu ka telashe në Komunën e Podujevës. Ne nuk mund të bëjmë zgjerimin e rrugëve, janë këto që janë. Kemi filluar një proces shpronësimi për vazhdimin e rrugës kah xhamia për të rritur kapacitetin, por nuk mund të bëjmë riorientime. E dyta, parkingjet nuk mund ti shtojmë përveç këtyre që i kemi. E tëra çka kemi mundur të bëjmë ka qenë që kemi lëshuar një pjesë tonën të hapësirës publike. Ne e kemi edhe një parking tjetër publik të cilin e kemi ruajtur për qytetarët tanë. Sa i përket shërbimeve është vlerësim i të gjithëve se të gjitha shërbimet kryhen me kohë dhe atë shumë shpejtë. Nëse i shihni sportelet e Komunës i vëreni se janë të gjitha aktive, shërbimet kryhen me kohë dhe nuk ka pritje nga qytetarët. Gjithashtu në E-Kioskat në të cilat kryhen shërbime në terren të gjitha gjatë kësaj periudhe janë funksionale. Ajo që kemi pas problem dhe është e evidente është numri i madh i automjeteve dhe mungesa e resurseve humane të Policia të cilën e potencoi edhe Komandanti i Policisë. Ka nevojë për numër më të madh të policëve dhe për patrullime më të shumta, por kjo është brenda kapaciteteve që ka Policia. Jo vetëm Komandanti por edhe unë kam bërë përpjekje për rritjen e numrit të policëve, sepse normalisht edhe qytetarët kanë dëshirë dhe nevojë për të parë më shumë uniforma në qytet. Kemi çështjen e parkimit vend e pa vend të veturave në qytet ku qytetarët e shfrytëzojnë mungesën e patrullave policore dhe e shfrytëzojnë këtë mundësi. Edhe te pjesa ku shfrytëzohej nga taksistët ilegal ka një përmirësim të gjendjes sepse i kemi ndërmarrë disa masa. Trafiku është normal edhe pse ka rritje të numrit të automjeteve në këtë periudhë kohore. E tëra çka unë nuk jam i kënaqur e besoj as ju është parkimi i automjeteve nëpër trotuare dhe hapësira tjera publike dhe pengimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve çështje për të cilën kemi diskutuar shumë herë me Komandantin e Policisë, por ky është numri aktual i zyrtarëve policor dhe rritja e numrit nuk po varet nga ne. Thjesht besoj se ju edhe qytetarët por edhe ne si institucione lokale duhet të jemi shumë të kënaqur që po përmbysim një sezon me një numër enorm të bashkatdhetarëve tanë pa asnjë eksces gjë që është sukses shumë i madh. I tërë ky sukses i atribuohet edhe këtij numri të vogël të zyrtarëve policor, por edhe i të gjithë juve si dhe i qytetarëve të cilët kanë qenë në nivel. E them këtë duke pas parasysh problemet që kanë ndodhë në shumë komuna gjatë kësaj periudhe kohore. Neve na janë rritur problemet për shkak të mbeturinave, me kërkesa për të pasur më shumë ujë dhe të gjitha këto kemi bërë përpjekje me këto kapacitete që kemi ti menaxhojmë. Kemi Njësinë Pastrimi që relativisht kemi telashe. Është periudhë e verës që duke marrë përbazë pushimet në masë rritë problemin e mungesës së kapaciteteve njerëzore. Jemi duke shkuar drejtë përmbysjes së kësaj periudhe dy mujore të qëndrimit të bashkatdhetarëve tanë, deri tash së paku pa ndonjë eksces të madh. Po besoj që përkundër vërejtjeve që i kemi deri tash jemi mirë. E theksoj, publikisht falënderoj për bashkëpunimin e mirë që kam pas me policinë por edhe bashkëpunimin e mirë me qytetarë. Ju keni parë për një mori aktivitetesh të ndryshme që janë zhvilluar gjatë këtyre 2-3 javëve dhe sigurisht se ka pas një angazhim bukur të madh dhe ka rrjedh gjithçka qysh është me se miri. Se a është krejt perfekt, normal që nuk është, por se a kemi pas telashe që vlen të potencohen, sigurisht që ka pas por janë të vogla dhe të menaxhueshme. Dëshirë e jona është të krijojmë më shumë hapësirë, për të përgatitur plan operativ ekstra për këtë punë, por kur nuk ke solucione për të zgjedhur, atëherë duhet të veprojmë

në kuadër të këtyre kapacitete që kemi. Për të zgjedhur një problem krijojmë problemin tjetër, kështu që analizat që janë bërë janë këto. Besoj që relativisht mirë ka shkuar situata gjatë kësaj periudhe kohore.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, parkingjet e shkollave janë mbyllur gjatë verës, gjatë pushimit vjetor. Nuk mendoj se janë më ndryshe se sa objekti i Komunës që ka një parking me një kapacitet të limituar. Pra kërkesa është për të krijuar mundësinë e parkimit të automjeteve në oborr të shkollave për këtë periudhë kohore me qëllim të reduktimit të numrit të tyre. Oborret e shkollave kanë mundësi për tu adaptuar për parking dhe të hyrat që sigurohen nga to do të mund të shfrytëzoheshin për renovim çfarëdo qoftë brenda hapësirës shkollore, si gjelbërim etj. E dyta të çështja e parkingut në trotuare, duke parë problemet dhe vështirësitë që po shkaktojnë në qarkullimin lirshëm është mirë të vendoset për ngritje të trotuareve për të penguar parkingun e veturave, ose të vendosen shtylla mbrojtëse. Unë pata rast të vizitojë Londrën dhe aty kam parë shtylla mbrojtëse në trotuare, po flasim për një qytet metropol. Kërkesa është të ngritën trotuaret me anësorë ose të aplikohet ndonjë metodë tjetër për të qenë pak më kreativ duke u lënë hapësira për furnizim të lokale afariste.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, falënderojmë parafolësin për sugjerimet e bëra, por mendoj se lëshuarja e oborreve të shkollave për parking për bashkatdhetarët nuk mendoj se do të zgjidhnin situatën sepse pjesa dërmuese e qytetarëve nuk i parkojnë veturat në oborre të shkollave që janë më larg qytetit për arsye se dëshirojnë me vetura të vijnë në qytet. E sa i përket ngritjes së trotuareve keni të drejtë se ajo edhe mund të bëhet, megjithatë duhet pas parasysh se çdo ngritje e trotuarit shkakton një varg problemesh tjera, nëse ne do ta ngitnim trotuarin në rrugën në drejtim të QKMF-së i kemi komplet lokalet afariste që zhvillojnë aktivitete, përveç asaj pengesat që i kemi pas me beton i keni parë në çfarë gjendje janë dhe kam marr iniciativë për t'i larguar të gjitha sepse është diçka e vrazhdë. Mendoj se këtë vit do të ketë ngritje të trotuareve aty ku krijohet mundësia dhe ku nuk do të pengohet afarizmi, ndërsa aty ku pengohet afarizmi duhet gjetur formë apo mënyrë tjetër për të mos penguar automjetet. Por në këtë aspekt rol shumë të madh luan Policia. Angazhimi i dy njësive policore në qytet me biçikleta do të mund të kryenin punë si duhet, unë vetëm e theksova sepse nuk është në domenin tim kjo punë. Shoh që ka angazhime në qytet por është numri i vogël i njësive, përderisa kërkesat janë në të shumta sepse jemi territor i gjerë, me sipërfaqe të madhe dhe numër të madh të vendbanimeve, kështu që nuk ka mundësi t'iu përkushtohen sa duhet qytetit. Inspeksioni nuk mund të marr masa për parking të palejuar, mund të dënohen taksistët nëse nuk janë parkuar në vendin e caktuar. Lidhur me këtë ne brenda ditës në vazhdimësi komunikojmë me Stacionin Policor, me Komandantin, qoftë edhe me zyrtarë tjerë atje, për të kërkuar shërbime prej tyre prej kërkesave të ndryshme, por megjithatë mungesa e zyrtarëve reflekton se ka çalime në këtë aspekt. Besoj që herën tjetër patjetër do të jemi të detyruar domosdoshmërisht për të shfrytëzuar parkingjet e objekteve shkollore aty ku është e mundur në këtë periudhë kohore dhe pjesa tjetër e cila deri tash është shfrytëzuar si parking, aty do të bëhet gjelbërim dhe sigurisht duhet të bëjmë një solucion tjetër për parking si zgjidhje. Besoj shumë që edhe pjesa e rrugës që kemi hy në shpronësim për hapjen e trasesë së re dhe me negociatat që jemi ka i zhvillojmë edhe me hekurudhat e Kosovës në mënyrë që edhe pjesën e trasesë së hekurudhës për ta kthyer në rrugë ndoshta në një masë do të ndikoj në zhbllokojë komunikacionin brenda qytetit. Pra jemi duke shqyrtuar me mundësitë që kemi për të bërë zgjidhje.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, Komuna ka buxhet andaj të kontraktohet një kompani për të bërë zgjidhje të trafikut në qytet. Unë e di se për të bërë zgjidhje komuna nuk ka

kapacitetet. Pra kërkesa është se a ekziston mundësia për kontraktimin e një kompanie që është më e mira e mundshme pa marrë parasysh koston me qëllim të rregullimit çështjen e trafikut. Po flasim për një qytet që është i pazhvilluar në kuptimin urban. Miratimi i Hartës Zonale hap rrugën e ndërtimeve të mëdha që krijon mundësinë për ngufatje të qytetit të Podujevës. Duke u bazuar në këto rrugë të vogla që kemi kanë për të dëmtuar qytetin në periudhë afatgjate e kjo normal si shërben askujt as ju në aspektin politik por as neve si qytetarë që jemi. Për t'i ndërruar pamjen dhe kahjen e zhvillimit të qytetit për 50 vitet e ardhme duhet të marren edhe vendime dhe veprime pak më radikale me qëllimin për të hapur rrugë për zhvillim të qytetit. Me këtë zhvillim të vogël që kemi në kuptimin urban, duke theksua se nuk kemi mundësi për të bërë më shumë parkingje, po më duket se është pak herët për tu dorëzua, thjesht nuk është zgjidhje. Pra propozimi im është kontrakti kompaninë e inxhinierëve që ka njohuri të merret me këtë punë me qëllim që të bëhet një zgjidhje afatgjate, sepse qyteti i Podujevës ka hapësirë. Çështja e shfrytëzimit të parkingjeve të shkollave është çështje përkohshme. Nuk po bëhen vërejtjet në ju si qeverisje sepse kështu e keni hasur, por një punë e mirë apo vepër do ti shërbente secilit nëse do të ishte bërë një zgjidhje afatgjate.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, pajtohem me sugjerimet e parafolësit. Nuk do të thot se nuk jemi të gatshëm të përballemi me këto gjëra sepse jemi duke punuar, por nuk mund të ecim shpejt në këtë aspekt, sepse çdo njëra prej punëve ka afate dhe procedura kështu që kërkohet kohë. Ne kemi filluar procesin e shpronësimit por janë një varg procedurash që duhet kaluar. Dua të theksoj se është një plan mobiliteti dhe konformë atij plani jemi duke i bërë disa veprime dhe besoj se do të jetë më mirë se sa që e kemi hasur kështu. Pra ka elemente pozitive por jo të mjaftueshme sa janë kërkesat.

**z. Nuhi Selimi,** theksoi, që flasim për çështje të sigurisë publike është diçka tjetër nga çështjet që i takojnë shërbimeve publike, si fjala vjen çështja e parkingjeve është kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, kemi respekt për shoqërinë civile, kështu që presim edhe propozime konkrete nga ta dhe propozimet për parkingje janë të mirëpritura.

**z. Shemi Jashari,** theksoi se termi siguri publike është më i gjerë se sa që theksoi z. Nuhi Selimi. Në sigurinë publike bën pjesë gjithçka, qoftë kur është puna e një trotuari, një parkingu, qentë endacak, fëmija kur shkon në shkollë, një qytetar me nevoja të veçanta kur nuk është në gjendje të kryej shërbime etje, të gjitha këto janë sigurime publike.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, po besoj përfunduar me këtë pikë, në qoftë se dikush tjetër nuk ka diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

### **3. Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve dhe djegieve të pyjeve, dhe vërshimeve (koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent**

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, ajo që është evidente deri këtu së paku nga informatat që i kemi marrë ka disa zjarr vënie të vogla por që nuk kanë shkaktuar ndonjë problem serioz. Për më në detaje do të ju njoftojnë Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, njëherit i autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltlarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR dhe z. Kujtim Zhitia i autorizuar për të paraqitur informatën, pasi që Drejtori i Drejtorisë së

Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH gjendet në pushim vjetor. Fillimisht fjalën e ka z. Vigan Salihu.

**z. Vigan Salihu,** theksoi, DBPZHR ka përcjellë procesin e korrje shirjeve në territorin e Komunës. Nënvizoi, kemi monitorue situatën në terren në koordinim me koordinatorin e caktuar për emergjenca dhe kemi ndërmarrë veprime sipas nevojës. Në këtë vit në raport me vitin paraprak qëndrojmë shumë mirë, me një numër të vogël të rasteve që kemi pas për intervenim.

**z. Kujtim Zhitia,** theksoi, Njësiti Zjarrfikës ka qëndruar në gjendje gatishmërie gjatë kohës së korrje shirjeve dhe së bashku me zyrtaret e Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural kemi përcjell korrje shirjet.

Në shërbimin zjarrfikës kemi 14 zjarrfikës, një shef, dhe një zyrtar të preventives për zjarr. Kemi 5 automjete të cilat bartin ujë për fikjen e zjarrit, një kamion teknik i cili përdoret për ndeshjet në komunikacion, pastaj 5 pesë motorë kompresorë të cilët vendosen në krahë për fikjen e zjarrit në hapësira fushore dhe malore .

Gjate muajit Gusht i kemi pas 28 intervenime dhe atë; zjarr fushor, hamullore 14 raste; zjarr në mbeturina 05; ushqim bagëtish 02; zjarr- veturë e djegur 01; zjarr - garazh për veturë 01; zjarr në orë elektrike 01; zjarr në një objekt afarist një pjesë 01; Intervenime teknike 03.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Shemsi Jashari,** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës a ka mundësi për të na treguar se cilat masa parandaluese janë ndërmarr dhe çka është bërë për parandalimin e shfaqjes së zjarreve. A është ndërmarrë ndonjë veprim paraprak apo thjesht është një evidentim i asaj që ka ndodhur. Pra a ka ndonjë fushatë informuese apo cilat aktivitete janë mbajtur qofshin ato të koordinuara apo të pa koordinuara.

**z. Kujtim Zhitia,** theksoi, Ekipi i zjarrfikësve dhe shpëtimit në vazhdimësi është në gjendje gatishmërie për të intervenuar aty ku paraqitet nevoja.

**Shemsi Jashari,** theksoi, se si fokus do të kishin me qenë aktivitetet në çështjen e parandalimit të zjarreve, vërshimeve, lirim të hapësirave të caktuara, uzurpimeve të hapësirave të caktuara. Nënvizoi procesi i themelimit të këshillave të fshatrave ka filluar dhe besoj se do të vazhdojë. Duhet potencuar se shkaktar të mundshëm të zjarreve mund të jenë edhe prerësit ilegal të pyjeve të cilët fillimisht kanë për qëllim për të djegur një hapësirë të pyjeve. Është dashur të jetë një plan i informimit publik ku do të jenë krejt aktorët, për të shikuar edhe aspektin rregullativ. Ka edhe të tillë që janë përfitues të subvencioneve të Komunës, ndërsa në të njëjtën kohë janë duke kryer veprime ku po shkaktohen dëme. Pra nuk është në rregull që të jetë një subvencionues prej Komune t'ia vë flakën ndonjë hapësirë dhe të shkaktojë dëme tjera. Duhet të ndërmerret ndonjë masë edukuese për ta që nëse ndodhë ndonjë veprim i tillë nuk mund të jetë edhe në të njëjtën kohë përfitues i subvencionit. Çështje tjetër është prioriteti i projekteve në pikat kritike, për të investuar, në mënyrë që mos të paraqiten prapë, e pastaj duhet marrë me pasoja, sikurse është fjala për vërshimet, ku dëmet sillen në shumën rreth 2 mil. euro. Pra këtu mungon informimi publik edhe te pasojat e zjarreve të shkaktuara, e që institucionet në këtë rast është dashur të bashkëveprojnë dhe për të kryer më shumë punë në këtë drejtim. Sa i përket zjarreve për fat këtë vit nuk patëm shumë raste, mirëpo është më mirë të ndërmerren masa parandaluese.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, besoj që në si institucione lokale vazhdimisht jemi duke punuar në parandalimin e vërshimeve, në veçanti është duke u bërë një punë shumë e madhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe

Shpëtimit në hapjen e rrjedhave ujore dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve me qëllimin e vetëm që të parandalohen vërshimet të cilat kanë ndodhur. Tashmë një pjesë e gjatë e lumit Llap dhe lumit Dumnica janë hapë. Është duke vazhduar rregullimi i shtratit të lumit Llap. Është punuar në fshatin Bradash në hapjen e një rrjedhje ujore e cila dy herë ka paraqitur probleme për banorët e disa lagjeve. Me një fjalë janë duke u kryer një varg punësh me qëllim të parandalimit të këtyre vërshimeve. Sigurisht nganjëherë edhe kapacitetet buxhetore nuk janë të mjaftueshme në këtë aspekt. Sa i përket masave të parandalimit nga zjarri ajo që është e evidente ne kemi njësinë e zjarrfikësve dhe besoj se në çdo kërkesë dhe nevojë të paraqitur janë në gatishmëri tu përgjigjen dhe të përballen me të gjitha ato sfida. Gjithmonë ka vend për më mirë por nuk jemi në gjendje të keqe.

**z. Avni Fetahu**, theksoi, mendoj te masat senzibilizuese, po filloj nga shkollat, në takimet me Eko klubet dhe punimet që i kam pas me ata nxënës dhe prezantimet e prindërve të tyre në ato klube ka ndikuar në vetëdijesimin për masat senzibilizuese kundër zjarreve. dhe ky vetëdijesim edhe atëherë kur kam qenë drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku ka pas pasur vërtetë shumë zjarre, kjo ka ndikuar jashtëzakonisht mirë. Një diskutim e kemi pasur edhe në përbërjen e KKSB-së si dhe me komunitetin fetar që edhe këta kanë fole për këtë temë për ngritje të vetëdijes dhe djegia e këtyre hamulloreve është vlerësuar se vetëm dëme i shkakton tokës. Pra ka pas masa vetëdijesuese prej të gjithë akterëve në Komunën tonë.

**Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame**, - theksoi, më datë 28 korrik në të gjitha xhamitë janë paraqitur dy pika, dhe atë;Festo pa armë që ka ardhur si kërkesë e Policisë së Kosovës dhe pika tjetër për vetëdijesimin dhe parandalimin e djegies së hamulloreve dhe fushave dhe kjo nuk është hera e parë që ne si Bashkësi Islame i referohemi këtyre temave dhe kjo me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi a ka dikush tjetër të marrë fjalën lidhur me këtë temë, nëse e jo kalojmë në pikën e radhës.

#### **4. Informatë dhe diskutim për projektet ( të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të komunës**

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, faktikisht ne kemi bërë një draftim/kornizë buxhetore dhe kemi vu disa pika më kryesore në kuptimin e projekteve kapitale që planifikohen të realizohen. Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, që e kemi prezentë mund të ju informojë më në detajisht rreth këtyre projekteve dhe sigurisht presim edhe nga ana e juaj nëse keni eventualisht ndonjë sugjerim sepse ky projektbuxhet ka me u procedua edhe në diskutim publik ku do të ketë mundësi të involvohet edhe shoqëria civile por edhe subjekte tjera për të dhënë kontributin e tyre për ta realizuar si projektbuxhet final për vitin 2024.

**z. Fatlum Osmani**, theksoi, ne si Komunë- Drejtorja e Buxhetit dhe Financave jemi në fazën e planifikimit të projektbuxhetit për vitin 2024. Komuna veç se e ka të miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore ku janë të orientuar dhe planifikuar projektet të cilat parashihen në vitin 2024 dhe projeksionet buxhetore 2025-2026. Nga java e ardhshme do të fillojnë diskutimet për projektbuxhetin e vitit 2024 i cili pritet të miratohet në muajin shtator. Ne i inkorporojmë kërkesat dhe propozimet nga diskutimet publike por edhe nga strukturat tjera qoftë edhe të KKSB-së, projekte të cilat mund të ndikojnë dhe prekun në sigurinë e qytetarëve në mënyrë që ti inkuadrojmë në projektbuxhetin e viti 2024. Në bazë të limiteve buxhetore që i kemi mbulojmë kërkesat dhe nevojat e



paraqitura. Gjatë javës do të arrijë edhe Qarkorja e 2 buxhetore e cila do të përcaktojë strikt limitet buxhetore. Ne mirë presimin propozimet e juaja.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, e hap diskutimin lidhur me këtë pikë.

**z.Nuhi Selimi,** theksoi, unë i përcjell shqetësimet e banorëve të fshatit Orllan. Kemi problem te ura në Orllan ka shumë nevojë për ndërtimin e një trotuari, andaj kërkoj përkrahjen e juaj, sepse fëmijët gjatë shkuarjes dhe kthimit nga shkolla po i ekspozohen shumë rrezikut. Pra kjo është kërkesë e kamotshme. Një kërkesë tjetër kam për vendosje të pengesave në rrugë sepse ka shumë vozitës të pa përgjegjshëm sa i përket vozitjes. Çështje tjetër është rruga për në fshatin Ballaban, çdo ditë është duke rrëshqitur ajo pjesë , andaj duhet intervenuar. Çështje e fundit është hedhja e mbeturinave përgjatë Liqenit. Çdo vit 2 punëtorë janë marrë me punën e pastrimit e që tani nuk janë. Pushuesit e pandërgjegjshëm po i hedhin mbeturinat vazhdimisht. Nëse nuk ka mundësi që të merren parasyshtë në këtë projekt buxhet, së paku të përfshihet vetëm rregullimi i trotuarit te ura sikurse e theksova.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, sigurisht që katër kërkesat e paraqitura nga parafolësi janë të nevojshme, por problemi sikurse e dini është çështja e urës dhe e rrugës është në kuadër të kompetencave të nivelit qendror, nuk e jona, por duhet shqyrtuar mundësia dhe të bëhet zgjidhja. Ne trotuarin mund ta bëjmë deri te ura, mirëpo te ura është problem zgjerimi i saj. Për çështjen e trotuarit duhet të shikojmë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike për ta futur si projekt nëse nuk është i planifikuar këtë vit. Çështja e vendosjes së pengesave në rrugë, mendoj se duhet menduar për reduktimin e tyre dhe për te vendosur vetëm ku patjetër vlerësohet se duhet te jetë. Për te shkolla çdo veprim që ndërmerret duhet të bëhet në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës pasi që është rrugë rajonale. Nëse do të vepronim ne duhet paraprakisht të marrim pëlqim nga ana e tyre. Rruga te fshati Ballaban është shqetësuese, aty është bërë një investim, është punuar edhe këtë vit në sanimin e asaj rruge, mirëpo pavarësisht punëve që po bëhen prapë po paraqiten probleme sepse fizibiliteti i saj nuk është bërë me kohë, megjithatë po mundohemi ta mbajmë nën kontrollë me intervenime të kohëpaskohshme, por edhe ato intervenime po kanë kosto sepse mirëmbajtja e saj është më e vështirë sidomos pas çdo reshje atmosferike. Sa i përket mbeturinave, është shumë e vërtetë se gjendja është e keqe , e kjo dukuri është edhe në qytet. Është Ndërmarrja “ Pastrimi” Njësia në Podujevë, por kemi telashe me të sa i përket menaxhimit. Ajo nuk ka kapacitete të mjaftueshme dhe nuk jam i kënaqur me punën e saj, sepse në një farë forme edhe jemi duke e paguar, por shërbimin nuk janë duke e kryer si duhet. Të gjitha komunat të cilat menaxhohen nga kjo Ndërmarrje kanë telashe. Ne jemi në proces të formimit të ndermarrjes së re komunale të cilën do ta menaxhojmë ne drejtpërsëdrejti, andaj edhe pritet që një pjesë e kompetencave sa i përket kryerjes së shërbimeve duhet t’i barten kësaj ndërmarrjeje nga ajo “Pastrimi”. Si pasojë e moskryerjes së shërbimeve problemet po barten te ne si institucione lokale, e këto i kemi si te furnizimi me ujë të pijshëm, ashtu edhe te mbeturinat. Ne si Komunë bëjmë pagesa për kryerjen e shërbimeve edhe në fshatrat Orllan e Batllavë, por s’jemi duke marr shërbime. Jeni shumë të bindur se kemi pas shumë telashe dhe kemi telashe edhe sot në mëngjes sepse nuk i kryejnë punët e veta. Shpesh na duhet të shkojmë me ndërmarrje tjera kontraktuese për t’i kryer punët që realisht janë punë dhe shërbime që duhet t’i kryejnë këto ndërmarrje. Ne kemi shumë telashe me to. Ne tash kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të marrë 14 punëtorë me një kontratë sezonale, sepse sikurse e dini neve na është cenuar e drejta për të pranuar punëtor me kontratë mbi vepër, mirëpo siç duket nuk ka persona të interesuar për t’u angazhuar në këtë marrëdhënie pune, edhe pse kemi ofruar një pagë mujore 450 €. Sot kam kontaktua edhe Zyrën e

punësimin në Podujevë për shikuar mundësinë që të bëhet pranimi i punëtorëve prej komunitetit ashkali, por s'ka të interesuar, ndërsa në anën tjetër fare nuk ta lëshojnë derën duke kërkuar punë, pra kërkojnë, ndërsa në anën tjetër nuk janë të interesuar për punë. Shoqëria civile është duke marrë disa projekte për në atë pjesë por nuk po shohim ndonjë rezultat prej atyre projekteve. Patëm një iniciativë me Drejtorinë e Burgut të Sigurisë së Lartë për angazhimin e të burgosurve për këtë çështje të pastrimit, por edhe pse në fillim shprehën interesim, ata u tërhoqën. Ne nuk mundemi të hartojmë memorandumin e fushëveprimit të punëve, por këtë mund ta bëjnë vetëm Drejtoria e burgut në kuadër të përgjegjësisë që u lejohet edhe pse ne u kemi hartuar draftin e memorandumit dhe u kemi dërguar në mënyrë që ata ti paraqesin kushtet dhe pikëpamjet e veta, por nuk pranuan edhe pse në fillim shprehën gatishmërinë.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, si kërkesë e imja është që mundësisht të investohet në një fushë të sportit në fshatin Kërpimeh, e cila daton që nga vitet 70-ta, e cila tani nuk është funksionale për shkaqe teknike. Përpara në atë fushë u zhvillua një aktivitet shumë i theksuar, ndërsa tani rinia nuk po ka mundësi ku të zhvillojnë një aktivitet. Mendoj, si nevojshme që të investohet në atë fushë është thurja e saj. Çështje tjetër është një banor i fshatit Bellasicë, i cili aktualisht jeton në fshatin Zakutë ka bërë një kërkesë verbale për rregullimin e rrugës Murgull- Bellasicë, pasi që ka hapur një biznes të bletëve dhe ka bagëti atje, por për shkak të rrugës nuk është duke arritur të zhvillojë aktivitetin sa duhet. Një punë e mirë është bërë në sanimin e rrugës, rregullimin e një grope të thellë te ura, pasi që ishte me një rrezik shumë të madh. Si kërkesë të fundit kam që të investohet në riparimin e shkollës së vjetër në fshatin Kërpimeh, për të krijuar kushte, mundësisht për hapjen e një çerdheje, sepse ajo pjesë ka nevojë shumë për një çerdhe.

**z. Shpejtëm Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, sa i përket fushës sportive, rrethoja nuk e ndalon zhvillimin e aktivitete nga ana e të rinjve. Shkolla sigurisht ka mjete kositëse të barit dhe punëtor teknik të cilët është dashur të angazhohen për kositjen e barit, ku do të rregullohej fusha dhe mund të zhvillohen aktivitetet. Nëse duhet të intervenohet diçka në fushë e që nuk mendoj se ka nevojë pasi që është funksionale, mirëmbajtja duhet të bëhet nga ana e juaj. Nëse ka nevojë diçka të investohet nga ana e Komunës ne e bëjmë, fjala vjen nëse janë dëmtuar shtyllat ato i ndërrojmë. Mirëpo këtu duhet aktivizuar edhe komuniteti, sepse është në dobi të tyre. Ju e keni edhe një fushë tjetër të ndërtuar që është në shfrytëzim. Pra e përsëris fushën duhet ta mirëmbani vet. E dyta, rruga Murgull-Bellasicë, është investuar vitin e kaluar në këtë rrugë. Nëse e ka dëmtuar dimri që nuk kam informacione, por kjo ka qenë projekt i Ministrisë së Infrastrukturës ku janë investuar 60,000 € në atë rrugë. Pra nëse është dëmtuar dimrit atëherë duhet parë gjendjen dhe duhet sanuar ku ka nevojë. Edhe shkollën e vjetër domosdoshmërisht duhet futur në funksion, pra objektin duhet riparuar. Tashmë e kemi një projekt që duhet të hapet për riparim të objekteve shkollore, kështu që shkollën mund ta shfrytëzojmë qoftë për çerdhe, qoftë edhe për interes të komunitetit lokal atje, sepse është objekt i mirë dhe nuk duhet lejuar të shkatërrohet. Mos prisni që këto të kalojnë vetëm në KKSB por ndiqni procedurat me drejtorinë përkatëse që i mbulojnë fushat e caktuara për të zgjidhur këto çështje. Por këto referime është mirë të bëhen në fillim të vitit kur bëhen planifikimet e zbatimit të projekteve, e jo në përfundim të vitit, kur edhe shpenzohen mjetet buxhetore, sepse mjetet buxhetore planifikohen me kohë. Ajo që për mua është interes i madh këtu është që ju duhet të më krijoni kushte për rregullimin e urës, sepse vitin e kaluar dështoi projekti për shkak të pengesave që i bëri komuniteti atje. Një ditë sa isha prezentë atje, një shofer me një kamion hasi në shumë vështirësi për të arritur me hy në atë urë. Duhet fol me komunitetin atje për të mos vendos pengesa asaj

ure, sepse bizneset që zhvillojnë veprimtaritë për shkak të asaj ure kanë telashe. Me këtë punë është mirë të merreni ju edhe si Drejtor i shkollës, prej pozitës së drejtorit, me u fole banorëve që mos të qesin pengesa. Unë për shkak të pengesave u detyrova që projektin ta bartë diku tjetër. Për ndryshe mos të detyrohemi që t'i hyjmë procedurave.

**z. Qefser Behrami**, theksoi sa i përket projektit të urës, është problem të bisedohet me personin që paraqet pengesë sepse nuk donë të kuptojë dhe ka qëllime të caktuara për të penguar në realizimin e disa projekteve. Sa i përket rrugës Murgull-Bellasisë, po është shtruar, mirëpo është dëmtuar prej të reshurave atmosferike, andaj do të ishte mirë të dilet dhe të konstatohet mbi gjendjen e saj. Për te fusha e sportit që e potencova më herët aty është e nevojshme një makinë kositëse më e madhe, sepse me këto të voglat që i kemi nuk mund të kryhet puna.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, do të angazhojmë një kompani që të intervenojë në fillim për kositjen e barit, pastaj ajo duhet të mirëmbahet nga ana e juaj.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi ne si komunitet kemi një shqetësim në lagjen "Ali Ajeti" për ujin e pijes. Gypi furnizues është nga materiali azbest dhe është kalbur, kështu që uji nga ai gyp është i papërdorshëm. Mendojmë se jemi në rrezik dhe nëse nuk bëhet përtëritja e gypit furnizues të ujit ka rrezik për ndonjë helmim në masë aty me pasoja shumë të mëdha. Ne këtë shqetësim e kemi adresuar edhe më herët, por ndoshta për shkaqe të mjeteve apo për ndonjë arsye tjetër ende nuk është ndërmarrë asgjë. Komuniteti me mjete vetanake ka bërë përpjekje për ndërrimin e gypit por nuk kemi pasur mundësi ta bëjmë për arsye se banorët aty janë në gjendje të rëndë ekonomike. Gjatësia e gypit është rreth 300m. Problemi është se ajo familje që ka mundësi blen ujin për pije ndërsa ato që nuk kanë këtë mundësi e përdorin ujin nga ai gyp.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, çështja e cekur nga parafolësi është shumë e qëlluar. Do të bëjmë çmos çka është e mundshme për të zgjidhur këtë problem. Edhe pse desha të shtojë se me buxhetet duke filluar nga ky vit këto investime komplet kanë kaluar në kompetencë dhe përgjegjësi të Ndërmarrjes Rajonale "Pastrimi", por sidoqoftë ne nuk do të heshtim do të mundohemi të sigurojmë mjetet për zgjedhjen e këtij problemi, nëse kompania nuk shpreh gatishmëri, ne e marrim përsipër.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, vetëm desha të inkuadrohem për një sqarim të vogël në kuadër të këtij projekti. Kjo ka qenë vitin e kaluar ku Zyra e Kryeministrit për Komunitete ka paraparë paramasën dhe paralogarinë për projektin në fjalë. Ne kemi intervenuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes de Shpëtimit ku kemi dalë në terren, e që prezentë ishte edhe inxhinieri nga Kompania e Rajonale e Ujësjellësit ku janë bërë të gjitha paramasat dhe ka dalë me një kosto rreth 38,000 €. Ne e patëm dërgua këtë projekt. Në bazë të informacioneve që kemi pas Ministria veç se e ka miratuar për të na ndihmuar në këtë projekt, dmth Zyra pran Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë për Komunitete, por kjo ka mbetur prej vitit të kaluar. Në kuadër të mundësive është jashtëzakonisht e nevojshme dhe e domosdoshme të ndihmohet në realizimin e këtij projekti në bashkëpunim edhe me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit – Prishtinë.

**z. Shemi Jashari**, theksoi, ne me materialin e mbledhjes ka qenë dashtë ta kemi një informatë të shkruar për të pas mundësi të përgatitemi. Si KKSB na intereson me prioritet për të treguar në aspektin e sigurisë që përmbajnë projektet, jo projektet si tërësi, por ato që reflektojnë në aspektin e sigurisë për të pasur mundësi të japim kontributin tonë për çka jemi thirrur. Pra nuk kemi një informatë cilat projekte janë iniciuar dhe çka planifikon Komuna për të realizuar në vitin 2024, për të pasur mundësi të dimë dhe të japim kontributin tonë këtu. Nuk kemi vlerësim nga këndi i sigurisë të secilit investim publik dhe shërbim publik që kishte për të identifikuar pikat kritike të rrezikut, telashtet që

kanë qenë për të pasur mundësi të bëjmë një krahasim se cilat kanë qenë pikat kritike të rrezikut dhe për të pas mundësi të dimë se sa po përfshihen në këtë planifikim buxhetor, dhe sa prej tyre mbesin për të pas mundësi ne të japim kontributin dhe rekomandimet tona. Pra fjala vjen nëse i kemi 10 projekte ose tema që lidhen me aspektin e sigurisë, e nëse do të mund të adresoheshin vetëm 5 prej tyre atëherë është dashur të adresohen ato më të rëndësishmet. Mendoj se është dashur ta kemi atë informatë, në mënyrë që ne do të kishim mundësi ti adresojmë kërkesat ose rekomandimet tona.

**z. Fatlum Osmani**, theksoi, ne kemi KAB-in e cila është e publikuar në ueb faqen e Komunës, dokument ku janë të specifikuar të gjitha projektet e planifikuara për periudhën përkatëse kohore. Tani jemi në fazën e planifikimit të buxhetit për vitin 2024 dhe e kemi mundësinë e ndryshimeve, janë të mirëpritura edhe propozimet e juaja për projektbuxhetin 2024, të cilat kanë idenë e sigurisë për qytetarë.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, projekt që ka të bëjë vetëm me sigurinë publike është problem ta kesh. Secili projekt ka këndin e sigurisë. Kërkesa është që listën e projekteve të investimeve kapitale inicuese që ju po mendoni ti realizoni në 2024 të na e dërgoni si listë për të pasur mundësi ne për ta shfrytëzuar në aspektin e sigurisë publike. Nëse ka një vlerësim të pikave kritike na i dërgoni, unë nuk kam parë dhe nuk jam në dijeni se a ka, kjo do të na ndihmonte të japim kontributin tonë. Unë dëgjova Komandantin e Stacionit të Policisë për numrin e madh të tiketave të shqiptuara në trafik dhe vlera financiare e realizuar nga tiketat është dashur të orientohet në aspektin e sigurisë e që munden me qenë radarët statik, kamera të sigurisë etj, pra me furnizua në mjete të destinuara në fushën e sigurisë publike. Tjetër te planifikimi i rrugëve nuk jam në dijeni se si është planifikuar për 2024 por është dashur që të mos fillohet me asfaltimin e rrugëve pa trotuar por kjo të bëhet njëkohësisht me një projekt, pra le të planifikohen rrugët por edhe trotuaret me të njëjtin projekt. Te çështja e vendosjes së pusetave në rrugë, vërehet se disa prej tyre kanë filluar të flenë. Për të pasur mundësi ne të japim kontributin tonë si këshill do të duhet të kemi një listë inicuese të projekteve, në mënyrë që projekt për projekt të japim rekomandimet tona.

**z. Fatlum Osmani**, theksoi, e sqarova edhe më herët, se lista e investimeve kapitale është në kuadër të KAB-it dhe e publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës, por nuk do të thotë se ne detyrimisht duhet ti përmbahemi asaj liste, ndryshimet të cilat konsiderohen të nevojshme mund të bëhen nga lista e investimeve kapitale, në mënyrë që projektbuxheti i cili do të miratohet në shtator t'i përgjigjet interesave dhe sigurisë së qytetarëve.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, vetëm desha një plotësim sa i përket projekteve. Çdo njëri prej atyre projekteve, qoftë trotuaret, qoftë shuma buxhetore e planifikuar për qentë endacak, ndriçimi publik etj hyjnë në domenin e projekteve që e rrisin masën e sigurisë publike dhe të gjitha këto projekte janë të planifikuara dhe janë të specifikuara në KAB, e cila është e publikuar në ueb faqen e Komunës. Nëse ka ndonjë sugjerim në këtë do të jenë të mirëseardhura. Këto propozime apo planifikime paraprake do të kalojnë nëpër faza të diskutimit publik, ku këtë vit kemi planifikuar të mbajmë 9 diskutime publike në qendra dhe lokacione të ndryshme. Nga këto diskutime besoj se do të vinë propozime të reja. Pra desha të them se në masën më të madhe projekte ndërlidhen edhe me sigurinë e qytetarëve.

**z. Shemsi Jashari**, theksoi, lista e projekteve të përgatitura dhe planifikuar në këtë fazë të kalimit të projektbuxhetit për vitin 2024, duhet të ndahet nga pjesa tjetër e materialit në mënyrë që të jetë sa më i qasshëm edhe për qytetarë, sepse është pak vështirë edhe për qytetarin të hyjë në ueb faqe dhe të gjendet në këtë platformë, fjala vjen te Drejtoria e Buxhetit dhe Financave vetëm emri i drejtorit është, edhe ashtu ka vështirësi në hapjen e

ueb faqes komunale, kështu që kur flasim për investime kapitale, një faqe të formatit A4 ndani projektet dhe publikojeni, mundësisht në faqen ku është Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, atëherë kush ka interes i qaset listës.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi atë që përmendi parafolësi edhe mund të bëhet sepse nuk farë problemi i madh, mund të publikohet si pjesë e veçantë me projekte. Do të ishte mirë që në funksion të vetëdijesimit të qytetarëve prej shoqërisë civile të bëhet një projekt i mirë se si qytetarët të kenë qasje dhe të shfrytëzojnë ueb faqen e Komunës dhe të kenë qasje në informacionet e nevojshme. Mendoj se do të ishte mirë të fillohet të punohet diçka në këtë aspekt. Tjetër, çështja e takimeve me qytetarë, ajo që varet nga ne si njoftimi publik përmes mjeteve të informimit përmes rrjeteve sociale, bëhet me kohë, dhe nuk është problemi se nuk ka transparencë, por është duke munguar edhe interesimi i qytetarëve. Nuk kemi asnjë lokalitet sipas kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore që nuk kemi përfshirë projektet, apo një numër i lokaliteteve këtë vit ndërsa vitin tjetër lokalitete tjera dhe kështu me radhë. Desha të them se ka projekte me gjithë përfshirje në tërë territorin e Llapit andaj është mirë që edhe ju të kontribuoni për ti joshur qytetarët për pjesëmarrje sa më të madhe sepse është në interesin e tyre.

**z. Shemsi Jashari,** theksoi se nuk të ka ra shpesh për të shfletua ueb faqen e Komunës. Janë mbi 1000 Njoftime të rreshtuara njëra pas tjetres dhe kjo nënkupton si të lexosh libër për të gjetur atë që kërkon, kështu që ndani nëpër drejtori.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, këtu nuk ka problem se materialin e projekteve mund ta ndajmë dhe atë sipas Drejtorive sepse kemi edhe zyrtaren që mbanë ueb faqen e Komunës e cila teknikisht mund ta bëjë këtë.

**z. Shemsi Jashari,** theksoi, nëse flasim me shifra, flasim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, fjala vjen unë nuk kam nevojë me shikua te Drejtoria e Bujqësisë se sa moto kultivatorë ka ndarë, kjo mua nuk më intereson, por më intereson te financat, ose nëse dua të hyj te çështja e subvencioneve se kush është përfitues atëherë kaloj te faqja e Drejtorisë së Bujqësisë.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi se tani më publikimet e përfituesve dalin vetëm me shifra, pa emra.

**z. Shemsi Jashari,** theksoi, nëse doni të rritni qasjen në ueb faqe pasi që është edhe interesim i juaji, atëherë ndani projektet nëpër Drejtori komunale.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, i sugjeroj z. Jashari që nëse ka mundësi të gjitha këto ide që ka t'ia kalojë zyrtares komunale që është e caktuar për mbajtjen e ueb faqes së Komunës, e cila më pastaj do të ketë mundësi të bëjë sistemimin e tyre. Vetëm të caktohet termini dhe ja bartni këto si ide. Gjithashtu nëse ka mangësi ueb faqja e Komunës të rregullohet duke angazhuar edhe stafin tjetër nga Zyra e TI.

**z. Shemsi Jashari,** theksoi, u përmend draft Plani i Reagimit Emergjent, më intereson deri ku ka shkuar kjo çështje.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, Draft Plani i Reagimit Emergjent është i gatshëm dhe do të procedohet për Kuvend për diskutim publik.

**z. Shemsi Jashari,** theksoi, dua të potencoj çështjen e transmetimit të mbledhjeje të KKSB-së. Mbledhjen e kaluar keni thënë se do të transmetohen. Është interes publik për qytetarët për të parë se jeni shumë transparent. Mund të transmetohen sepse këtu nuk ka diçka sekrete që diskutohet apo trajtohet.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** sa i përket transmetimit të mbledhjes, të shohim nëse ka bazë ligjore atëherë nuk mendoj se ka ndonjë problem për transmetim të drejtpërdrejtë.

**z. Nazif Sheqa**, theksoi, ka dy kërkesa, njëra është për rrugën “Ilir Kunushefci” e cila nuk ka trotuar, në drejtim të fshatrave Livadicë-Merdare, ka qenë dashtë të jetë një shteg për këmbësorë sepse ka hapësirë të mjaftueshme.

Dhe një kërkesë tjetër është për ndërtimin e trotuarit në afërsi të shkollës në fshatin Shtedim, aty kanë hedhur mbeturina, pothuajse pjesa më e madhe e trotuarit është e bllokuar dhe kalimtarët, sidomos nxënësit po janë të rrezikuar.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit fillimisht duhet shikuar projektin e Parkut industrial, ndërsa për parkingje duhet të drejtoheni te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit .

**z. Qefser Behrami**, theksoi, kam potencuar edhe më parë çështjen e pendave, duhet bërë zgjidhje, sepse një reshje sa do e vogël uji po depërton nëpër ara.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, jam në dijeni për atë që theksoi parafolësi dhe besoj se do të merremi me këtë çështje, sepse ato më shumë janë duke na sjellë probleme se sa që po i shfrytëzojmë.

Nëse dikush tjetër diçka për të shtuar e përmbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

## 5. Informatë për gjendjen e pyjeve

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, fillimisht fjalën e ka z. Vigan Salihu.

**z. Vigan Salihu**, theksoi, objektiv kryesor i drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është që të zvogëlohen sa më shumë prerjet ilegale dhe të evitohen të gjitha problemet si zjarret, kullosat ilegale, deponitë e mbeturinave inerte, nxjerrja e zhavorrit, dheut etje.

Me qëllim të pengimit të qarkullimit të masës drunore nga prerjet ilegale Drejtoria ka realizuar kontrole të rregullta nga ana e shërbimit mbrojtës dhe teknik të pylltarisë dhe në asistencën e zyrtarëve policor , kurse masë drusore e konfiskuar është 38.14 m<sup>3</sup>.

Nga shërbimi i mbrojtjes së pyllit kanë proceduar 84 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 10 fletëparaqitje për vepra penale të cilat janë te institucionet relavante. Me qëllim të konstatimit dhe vlerësimit të gjendjes në rajonet pyjore, deri më tani janë përfunduar 4 revizione pyjore në rajonet ekonomike pyjore Murgull, Turuqicë dhe Zllapushë. Deri më tani 39 pronar të pyjeve private janë pajisur me leje për prerje në pyjet e tyre private ndërsa të hyra të mjeteve financiare nga këto prerje janë 5803.58 €. Vazhdimi i punimeve në ngastrën 063 Katunishtë, 167-02, në Bradash dhe fillimi i punimeve në ngastrën 6302 në Murgullë për prerje selektive sipas udhëzimeve të inxhinierëve të Agjencionit Pyjor të Kosovës. Po ashtu është realizuar edhe kontrata për shitjen e masës drusore 140 m<sup>3</sup> dru zjarri nga depoja e përkohshme e pylltarisë në fshatin Peran.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, e hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës

## 6. Të ndryshme

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi a ka dikush diçka në pikën të ndryshme. Unë desha të ju jap një sqarim lidhur me kompensimin e anëtarëve të KKSB-së për pjesëmarrje në takime. Informatat që i mora para se të fillojmë me mbledhjen është se me Ligjin për paga në fuqi vetëm anëtarët e dy komiteteve të Kuvendit, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kompensohen për pjesëmarrje në mbledhje dhe vetëm ata që nuk paguhen nga buxheti i shtetit. Ndoshta do të zgjidhet

problemi, por njëherë përnjëherë e kemi këtë gjendje sipas këtij ligji. Nuk jemi në dijeni se si do të zgjidhet ky problem edhe pse mendoj se duhet të bëhet kompensimi për arsye se do të humbet interesimi për angazhim dhe dhënien e kontributit. Jemi në pritje që kjo çështje të merr një kahje sepse edhe ne jemi në pritje sepse kemi edhe disa komisione, sikurse Komisioni për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave etj. Pra ende nuk është definuar se si të zgjidhet kjo problematikë. Po shpresojmë ndoshta me një udhëzim administrativ së shpejti nga Ministria përkatëse duhet ti jap kahje këtij procesi, dhe deri atëherë e kemi këtë situatë. E ndjeva për obligim që të ju paraqes këtë vetëm si informatë, sepse ndonjëri prej jush mund të shtrojë si kërkesë apo vërejtje se pse nuk po realizohet kompensimi. Unë paraprakisht u konsultova me Zyrën Ligjore dhe pra jemi në pritje të zgjidhjes së çështjes së kompensimit.

**z. Nuhi Selimi**, theksoi, se çështja e kompensimit të anëtarëve të KKSB-së është në kompetencë të Komunës e jo e Ministrisë përkatëse.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, këtu kemi Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe zyrтарin e Zyrës Ligjore, kështu që këta janë më të thirrur sa i përket kësaj çështjeje dhe këto të dhëna mi transmetuan paraprakisht sepse dikush kishte shprehur interesimin dhe ka kërkuar që të sqarohet çështja e kompensimit.

**z. Fatlum Osmani**, theksoi, rreth çështjes së kompensimeve duhet kërkuara një interpretim dhe nëse na mbetet neve atëherë për shumën e kompensimit duhet të merret një vendim në Kuvendin e Komunës e jo ekzekutivi dhe kjo i takon vetëm anëtarëve të Këshillit të cilët nuk janë pjesë e institucioneve publike. Për ne që jemi pjesë e institucionit janë disa dispozita ligjore të cilat na e ndalojnë pagesën për pjesëmarrje në mbledhje, ndërsa ju që nuk jeni pjesë e institucioneve është çështje tjetër. Pra për të tjerët të cilët nuk janë pjesë e institucioneve publike duhet të gjendet rruga për pagesë

**z. Nuhi Selimi**, theksoi, mos kompensimi për takimet e mbajtura të KKSB-së ka kuptimin e dëmtimit, atëherë shtrohet pyetja pse të dëmtohem unë.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, besoj se nuk është interesi i askujt askënd për ta dëmtuar, vetëm të sqarohemi dhe pastaj i japim kahje procesit.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, mendoj se të gjithë ne që jemi këtu nuk jemi ardhur vetëm ashtu por na ka propozuar dhe është aprovuar përbërja jonë nga Kuvendi, atëherë edhe na takon kompensimi, e them këtë kushtimisht. Pasi që na takon kompensimi atëherë pse mos të ekzekutohen këto pagesa. Fjala vjen unë sot nuk jam në punë por kam ditë pushimi. Më parë këto kompensime na janë kryer.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, ju kuptoj se ardhja në takim ka një kosto sigurisht, koha që humbë mbanë në vete edhe shpenzime shtesë. Interesi është që ky këshill të jetë funksional dhe të funksionojë në interes të përgjithshëm, ndërsa për çështjet tjera do të veprojmë në përputhje me rregullativën ligjore. Nëse qëndrojmë mirë në aspektin ligjor nuk do të ketë telashe për lejimin dhe ekzekutimit e mjeteve financiare në emër të kompensimit.

Kryetari përmbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:30**

**Procesverbalin e mbajti**

**Sabedin Namani**

**Nr. prot.02-060/04-0074665/23**

**Podujevë, datë: 15.08. 2023**

